

**NJOFTIM PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Sipas nenit 13 të dekretit legjislativ 30 qershor 2003, n.196  
"Kodi për mbrojtjen e të dhënave personale"

I nderuar Zotëri / E nderuar Zonjë, ju informojmë se:

a) përdorimi i të dhënave personale që Ju kërkohen e që Ju na jepni (i përcaktuar nga ligji si "trajtimi i të dhënave personale") është i domosdoshëm për:

- përfitimin e shërbimeve të parandalimit, diagnostikimit, kurimit dhe rehabilitimit për të cilat keni nevojë (ndërsa Shërbimit shëndetësor të dhënat i duhen për arsye administrative dhe për të ndjekur e vlerësuar në kohë përshtatshmërinë e shërbimeve shëndetësore);
- mbrojtjen e pacenueshmërisë fizike të njerëzve të tjerë dhe të bashkësisë;
- të lejuar kërkimin statistikor dhe epidemiologjik;
- përfitimin e shërbimeve për të cilat Ju keni nevojë nëpërmjet komunikimit elektronik, për shembull midis mjekëve të territorit dhe specialistëve (p.sh.: receta e/o kërkesa për shërbime, receta farmaceutike, vërtetime, relacione për diagnozën, letra për dalje nga spitali, shërbime asistence në shtëpi të integruar, trajtime antikoaguluese nga goja, transmetimi nga larg i relacioneve e/o pamjeve radiodiagnostikuese, etj.);
- pjesëmarrjen në kërkimin shkencor dhe eksperimentimin klinik (që do të fillojnë pas marrjes së mëtejshme, për çdo rast, të pëlqimit tuaj të dhënë pas informimit të duhur);
- mundësimin, atje ku është e nevojshme, të mbrojtjes së entit.

Të dhënat tuaja mbliken dhe përdoren me ndihmën e mjeteve informatike (kompjuteri) ose shkruhen në letër; sidoqoftë, gjithnjë në mënyrë që të garantohen siguria dhe karakteri rezervat.

b) komunikimi i të dhënave personale është i detyrueshëm për të përfituar shërbimet shëndetësore; refuzimi eventual për të dhënë pëlqimin shkakton pamundësinë e marrjes së shërbimeve shëndetësore (me përjashtim të trajtimeve urgjente dhe të urdhëruara nga autoriteti publik).

Në rast shtrimi në spital, të dhënat tuaja personale dhe reparti ku jeni i/e shtruar do të jenë të disponueshme në qendrat e informacionit, për të lehtësuar futjen në pavijone të vizitorëve; në se ju nuk e dëshironi diçka të tillë, mund të shprehni, në çastin e shtrimit, mospëlqimin tuaj eventual, në rast se nuk doni t'i bëni të disponueshme këto të dhëna.

c) refuzimi i komunikimit të të dhënave personale që ju kërkohen (të dhënat e gjendjes civile, propozimi eventual mjekësor, librezat shëndetësore, librezat e përjashtimit nga pagesat e shërbimeve, të ardhurat, atje ku parashikohen) shkakton, sipas rasteve, pamundësinë e përfitimit të shërbimeve shëndetësore për të cilat keni nevojë e/o përfitimet ekonomike të parashikuara nga ligjet në lëmin e pjesëmarrjes së përbashkët në shpenzimet shëndetësore.

d) të dhënat për gjendjen tuaj shëndetësore nuk mund të bëhen publike; këto mund t'u komunikohen të tjerëve vetëm në rastet e parashikuara me ligj dhe për qëllimet e përshkruara në pikën a).

e) në çdo çast ju mund të kërkoni në se ekzistojnë ose jo të dhëna për personin tuaj dhe mund të kërkoni t'ju komunikohen në mënyrë të kuptueshme; mund të merrni informacion për përdorimin e të dhënave tuaja personale; mund të kërkoni fshirjen, transformimin në të dhëna anonime, dhe bllokimin e të dhënave që trajtohen në shkelje me ligjin, si dhe, në rast se jeni i interesuar, mund të kërkoni përditësimin, korrigjimin dhe plotësimin e tyre. Së fundi, për arsye të ligjshme, mund të kundërshtoni, tërësisht ose pjesërisht, mbledhjen e përdorimin e të dhënave të tuaja personale edhe kur janë në përputhje me qëllimin e marrjes.

Shërbimit të marrëdhënieve me publikun, që gjendet pranë Qendrës për Shërbimet Shëndetësore, Viale Verona, 38100 Trento (tel. 0461/904172, fax 0461/904170 – e-mail: urp@apss.tn.it), mund t'i kërkoni mënyrën e ushtrimit të të drejtave tuaja; Shërbimi do të kujdeset t'ia përcjellë kërkesat tuaja përgjegjësit të trajtimit të të dhënave që ju interesojnë.

f) "titullari i trajtimit të të dhënave" të komunikuar është Ndërmarrja Provinciale e Shërbimeve Shëndetësore (Azienda Provinciale per i Servizi Sanitari), me seli në via Degasperri n. 79 - 38100 Trento.

Drejtori i Përgjithshëm i Ndërmarrjes Provinciale të Shërbimeve Shëndetësore